



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 695/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada – Gillogjani anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkritazi me ankesën e parashtruar nga Adnan Gashi, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Shtime, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtare të publikuar nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura me datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Adnan Gashi, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Shtime, nga subjekti politik LDK, me shenjën ZL.Anr.695/2017 e datës 09.11.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 09.11.2017, nga Adnan Gashi, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Shtime, nga subjekti politik LDK, me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se në vendvotimet: 2201X/04R, 2215E/02D dhe 2206E/03R, dyshon se i mungojnë votat e disa personave.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në ankesën e parashtruar nuk e ka potencuar se sa vota i mungojnë në vendvotimet nr.2201X/04R, 2215E/02D dhe 2206E/03R, si dhe në mbështetje të pretendimeve ankimore në ankesë nuk ka ofruar asnjë dëshmi për të vërtetuar pretendimet në ankesën e parashtruar, në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, ku është përcaktuar: “*se vendosja për ankesa dhe apele nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”. Paneli gjatë vendosjes për një ankesë i shqyrton dhe i heton me kujdes të gjitha provat e bashkangjitura në ankesë dhe kur vlerëson se pretendimet ankimore nuk janë të provuara me prova nga parashtruesi i ankesës, siç është në rastin konkret, ku parashtruesi

parashtruesi i ankesës nuk e ka bashkangjitur asnjë provë lidhur me pretendimet e tij, e refuzon ankesën si të pabazuar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.695/2017 me datën 10.11.2017.

Kryesuesi i Panelit
Gylteno Sylejmani



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*